




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-30274/22 datë:24.10.2022



Npi – 01/349 datë: 31.10.2022

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 31.10.2022, është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I M B L E D H J E S S Ë - X - T Ë R R E G U L L T T Ë K U V E N D I T T Ë K O M U N Ë S S Ë S H T I M E S
E mbajtur më: 31.10.2022, (e hënë) në ora 9.^{oo} h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: z.Rrahman Jakupi, z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushi, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Adem Ramadani, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, z.Albana Podvorica, znj.Adelina Beqaj, z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Reshat Mujota, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Sanije Sadiki, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj dhe z.Rexhep Gashi.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Kuverndit kanë marrë pjesë edhe: (Nënkrytari, z.Faruk Beqa), Drejtorët: DKA, z.Lulzim Sahiti), (DZHE, z.Kastriot Shabani), (DAP, z.Valon Januzi), (DPUKGJ, z.Grejtalb Emini), (DSHMS, z.Isa Haxhiu), nga (ZKF-ja z.Bujar Ferati), Nga (Zyra për Informim, znj.Anita Kurti), nga (IT z.Shpëtim Gashi), nga (Njësi për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, z.Reshat Gashi), nga (OJQ "Y A H R" z.Bekim Krasniqi), nga (OSBE, z.Mefail Mustafa) znj.Valmira Hoxha, praktikante dhe z.Shqiprim Hyseni, praktikant.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstattoj, Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 27.09.2022,
2. Pyetje - Përgjigje,
3. Raport Nëntëmujor Buxhetor Janar-Shtator 2022,
4. Propozim-Vendim për caktimin e normave tatimore për vitin 2023,
5. Draft-Rregullore për organizimin, funksionimin, dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime, dhe lagje urbane, në komunën e Shtimes,
6. Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm ngastrën kadastrale Nr.752-0, Z.K – Carralevë,
7. Propozim – Vendim për formimin e Komisionit për Hartimin e Rregullores së re të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve
8. Draft-Strategjia për komunikim dhe marrëdhënie me publikun për periudhën 2023-2025,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimi për rendin e ditës.
z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, Pajtohem me pikat e rendit të ditës
*** Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 27.09.2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimi për këtë pikë.

z.Reshat Mujota; Përshëndetje, kam disa vërejtjeje, kur kam folur për drejtorit nuk kam folur për drejtorin e Inovacionit por për drejtorin e Bujqësisë, që ka qenë dhe që do të jetë sepse ishte premtim.

z.Rrahman Jakupi; Po shihet përmirësim te procesverbalet, te fjalimi im faqe 3 të shkruhet sqarimi që e kam dhënë për fjalën vandalizëm, të merret nga stenogrami. Citoj “Ne nuk i kemi thyer e as nuk i kemi demoluar pajisjet e Kuvendit, por vetëm i kemi marrë në mënyrë demonstrative, për ta mbrojtur ligjshmërinë në Kuvend. Pra kur folni fjalë këtu për vandalizëm duhet me pas kujdes se far po thuani. Po më pengon se pse ekzekutivi po përzihet në punët e Kuvendit”.

z.Reshat Mujota; Fjalitë ofenduese të Kryetarit nuk janë shënuar në procesverbal, kërkoj të shënohen.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja më 27.09.2022.**

Pika 2

Pyetje – Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimi për këtë pikë.

znj. Shkurte Msutafa; Pyetje për DPUKGGJ-në, ndërtimi i bibliotekës dhe Arkivës së qytetit kur do të fillon ndërtimi i sajë?

z.Adem Ramadani; Pyetje për DSMS-në, pse drejtori nuk po merr pjesë në mbledhje të KASHPU-së?

z.Reshat Mujota; Pyetja e parë për DKA-në, Pse Shkolla Filllore Bajram Curri nuk ka arsimtar të matematikës po ashtu edhe të Edukatës Fizike? Pyetje a dytë për DKA-në. si qëndron puna me lëndë djegëse nëpër shkolla të Komunës tonë, se sasia që keni dërguar nëpër disa shkolla është e vogël, si dhe janë ardhur tjera dru e tjera shkruajnë në kontratë, kush është mbikëqyrës i kontratës?

znj.Besartë Musliu-Spahija; Pyetja e parë për DSHMS-në, pse drejtori nuk po na u përgjigjet ftesave për mbledhje të KSHMS-së? Pyetja e dytë për DPUKGGJ-në, rruga Skënderbeu , a keni qenë me pa gjendjen e rrugës si është?

z.Muhamet Ademaj; Pyetje për DKA-në, përdorimi i narkotikeve nëpër shkollat tona është shqetësues, a keni ndonjë plan si Ta parandaloni këtë dukuri?

z.Rexhep Gashi; Pyetja e parë për DKA-në, e kam ngrit këtë çështje edhe më herët, furnizimi me lëndë djegëse a jeni vonuar me furnizim? Pyetja Pyetje e dytë për DKA-në, Shkolla “Lasgush Pogradeci”, qysh keni pranuar me vazhduar nxënësit mësimin edhe pse në këtë shkollë pikë uji nga qa tija e saj dhe pllaka janë te prishura? Pyetja e tretë për Drejtorinë e Inovacionit, kjo drejtori drejtoresha filloj me na dhënë disa informata por më jo, a është kjo drejtori me letra dhe pse nuk po funksionon? Pyetje e katër për DA-në, na patët njoftuar për vendosjen e GPS-ve nëpër vetura zyrtare, pse këto vetura po bujnë nëpër parkingje po ju ofroj disa foto te një veture zyrtare ku shihet e parkuar në trotuar?

znj.Albana Podvorica; Pyetja e parë për DKRS-në, pse drejtori nuk ishte prezent ne mbledhjen e Komitetit për Arsim KAKRS-së, a është në funksion kjo drejtori? Pyetja e dytë për DSHMS-në, lidhur me muajin për ndërgjegjësimin e opinionit për kancerin e gjirit, çfarë aktivitete ka zhvilluar kjo drejtori? Pyetja e tretë për DKA-në, a ka ndonjë afat kur përfundon renovimi i Shkollës “Emin Duraku”?

z.Besnik Seferi; Pyetja e parë për DZHE-në, Çështja e qeneve endacak u tha ne mbledhjen e kaluar që është duke u bërë hapa konkret, mirëpo deri tani nuk u be diçka? Pyetja e dytë për DPUKGGJ-në, rruga në Qestë të Reçakut është kryer shkel e shko, tani kur po flasim ajo rrugë ka gropa shumë të mëdha kur do të intervenoni në këtë rrugë? Pyetja e tretë për DPUKGGJ-në, kam një shqetësim të banorëve Të fshatit Carralevë, lidhur me stacionin ne këtë Lagjen Beha ky stacion nuk është i vendosur aty ku ka qenë, pse tani nuk është bërë ky stacionin në të njëjtin vend ku ka qen edhe më herët? Pyetja e katërt për DI-në, a është funksionale kjo drejtori dhe apo pritet mu emëruar dikush tjetër drejtor?

znj.Adelina Beqaj; Pyetje e parë për DSHMS-në, jemi në muajin rozë, pse kjo drejtori nuk e ka ndërmarrë hapin me pas mamografin në QKMF? Pyetje e dytë për DSHMS-në, pse barnat esenciale po mungojnë në QKMF? Pyetje për e tretë për DSHMS-në, lifti në QKMF nuk po punon që një kohë të gjatë, pse nuk po e funksionali zoni atë? Pyetje e katërt për DKA-në, çdo mëngjes në oborrin e Çerdhes ka shumë vetura çfarë hapa do të merrni në parkingun te Çerdhja?

z.Isa Haxhiu, drejtori i DSHMS; Pse ka munguar te komiteti sepse njoftimi më ka ardhur në E-mail privat dhe jo zyrtarë. Sa i përket pyetjes së memografit ka pasur një memograf në Ferizaj në dispozicion tonë 7 deri 8 gra janë dërguar dhe janë ndarë broshura lidhur me këtë muaj.

z.Kastriot Shabani, drejtori i DZHE; Rreth geneve endacak e kemi pasur një buxhet mbi 3900, në Prill e kemi bërë si tender ku kemi prit të vjen nga OSHP-ja, kemi pasur një përfitues të tenderit por kemi pasur edhe disa ankesa nga një Organizata Zvicerane që nuk po i kryejnë punët si duhet. Me marrjen e kësaj ankese menaxheri i kontratës z.Ejup Ismaili e ka ndërprerë këtë kontratë. Kemi bërë një ri tenderim ku kemi pasur një dyfishim të buxhetit për qenet endacak për vitin 2023-2025.

z.Valon Januzi, drejtor i DAP; Përshëndetje, dua të përgjigjem në pyetjen e Shkurte Mustafa lidhur me projektin e Bibliotekës dhe Arkivës. Me marrjen e mandatit kemi nisur takimet që ta kryejmë këtë projekt. Ministria e Kulturës na ka nda 300 mijë euro për këtë projekt procedurat e tenderimit do ti udhëheqë Ministria, mendojë që brenda vitit do të fillojmë me punët e këtij projekti, koha e saktë kur do të fillojë varet nga procedurat e zakonshme të tenderimit. Lidhur me pyetjen e Rexhep Gashit për parkingun e veturës zyrtare pasat në trotuar. Kjo veturë ka qenë në atë servisë për ndërrim të gomave dhe balancim, ishte një gabim i shoferit, data ka qenë me 17.10.2022 si pas GPS-it.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Përshëndetje, sa i përket rrugës “Skënderbeu” kontrata është dy vjeçare është duke vazhduar, sa i përket a e kanë vizituar besoj që çdo projekt e kam vizituar jo njëherë po 5 herë. Punët çka janë paraparë në kontratë për këtë vit janë kryer dhe janë bërë gjitha pagesat, shihemi në vitin tjetër. Sa i përket pyetjes së Besnikut lidhur me stacionin e autobusëve e kemi diskutuar edhe më herët është kompetencë e Ministrisë së transportit dhe është procedurë që komplet e udhëheq Ministria e Transportit.

Pika 3

Raport Nëntëmuor Buxhetor Janar-Shtator 2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Përshëndetje, materialin e keni marrë të shkruar, siç edhe e kemi obligim ligjor respektimin e ligjit. Bazën ligjore e keni të shënuar. Në vazhdim do të prezantojë të dhënat kryesore buxhetore për 2022 (shih dokumentin). Ju kërkohet që ta aproveni, nëse ka pyetje do të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa; Falënderojë, ZKF-në e ka prezantuar gjendjen reale. Po fillimisht te investimet kapitale kanë qenë afër 2.3 milion e që janë shpenzuar rreth 30 % për 9 muaj. Kurse drejtori i Urbanizmit i shpenzon vetëm 700 mijë d.m.th. që këta janë ardhur një ditë në punë e dy ditë jo. Dy shkollat më të mëdha të Komunës nuk u rinovuan para fillimit të procesit mësimor, kur dihet që ka pasur grevë dhe ka qenë pushimi i rregullt i nxënësve. Drutë po paguhen për me i marr bung dhe qarr ndërkaq që ato vijnë si shelne, qershi e arra. Pse i paguan drejtorët Kryetari. Thuhet se na ka lënë borxhe e ne iu kemi lënë 2.3 milion buxhet për investime kapitale e këta nuk din ti harxhojnë ku vetëm 30% e këtij buxheti është shpenzuar.

z.Kadri Emini; Përshëndetje, raportin duhet me kuptuar drejtë sepse u bë paksa e madhe kjo punë. Raporti pasqyron vetëm gjendjen reale të shpenzimeve. Te shpenzimet ka ndikuar edhe inflacioni ku operatorët ekonomik kanë hezituar shumë për me konkurruar në projekte. Me 30 % Komuna e Shtimes mundë te jetë liderë e shpenzimeve në Kosovë. Ne dimë që në proces të realizimit janë shumë kontrata që mundë të arrin vlerën në 30 %. Këtë raport duhet me votuar por edhe nëse nuk votohet nuk ka ndonjë peshe të madhe, sepse gjendjen e shpenzimeve nuk mund ta ndryshojmë. Gjendja nuk është ashtu siç po e paraqet opozita.

z.Reshat Mujota; unë kam vërejtje në mos punë, e jo në raportin shpenzimeve që e ka bërë ZKF-ja. Ky raport është votuar edhe në KPF me qyken e zorit. Unë nuk mundem me votuar pa ardhur drejtorët për me dhënë sqarime shtesë. Kështu me këtë mënyre qysh neglizhohet Kuvendi, ky raport nuk mund të kaloj.

znj.Shkurte Mustafa; Raporti e pasqyron punën e mirë të qeverisjes. Për të gjitha punët që janë kryer operatorët janë paguar me rregull. Kjo përqindje deri në fund të viti do të rritet dukshëm.

z.Besnik Seferi; Në këtë ulëse unë kam thënë se unë nuk e votoj, bashkë me Ruzhdiun kemi thënë se pse me lënë buxhetin për me shpenzua në dy muajt e fundit tash duhet me punua sepse këshillat e Përparimit janë të mirëseardhura ne e kemi trashëguar një buxhet të tillë dhe duhet me votua.

z.Përparim Ramusa; Replikë është mirë e mare që një kryetarë me pas kërkua falje që Kryetari dhe me i shkarku drejtorët nuk po kërkohet vota për buxhet por për mos pune.

z.Lumni Amrushi; Përsëndetje, desha me replikuar pak te asamblistët e LVV-së dhe të LDK-së. Buxheti është në rregull por shpenzimi nuk është në rregull. Me 22% nëse e heqim edhe kolektorin kjo tregon mos punë të drejtorëve. Është dashur me qenë më azhur drejtorët, me i filluar procedurat me kohë. Ishalla shpenzohet buxheti sepse janë në të mirën e qytetarëve.

z.Kadri Emini; E di që është thënë që LDK-ja është paterica e LVV-së por nuk është e vërtetë sepse kemi vetëm partneritet. Por edhe me qenë nuk ka problem, por me qenë 22 vjet patericë e një njeriu është shumë më keq.

znj.Shkurte Mustafa; Unë thash se shifrat do ta shohim sepse ato do të ndryshojnë.

z.Besnik Seferi; Nuk ka rëndësi se këtu se a është votuar ky raport apo jo.

z.Muhamet Ademaj; Falënderojë ZKF-në për raport po shihet që ka pas një ngecje.

z.Reshat Mujota; Pyetje për LDK-në cilat pjesë të programit i keni në bashkëqeverisje? Sa kam pa unë asnjë pikë nuk e ka por vetëm punon për Vetëvendosje. Për Besnik Seferin cila Komunë është me 30% na e thuaj me emër. Është mirë me bë një kërkim falje për një ushtar që ne e kemi ndihmuar e DSHP-ja ka kontratë për mirëmbajtje të varrezave në vazhdim (Prezantojë disa foto nga telefoni i tij).

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Dha sqarim për varrezat e veteranëve, ku tha se me të marrë njoftimin ne kemi vepruar dhe e kemi angazhuar një kompani që e ka rregulluar këto varreza.

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; E kemi pasur një buxhet të miratuar, ne kemi punuar mbi buxhetin e pranuar, mirëpo ne s'kemi lënë OJQ pa bashkëpunuar.

z.Reshat Mujota; Asgjë personale nuk kam me drejtorë, unë i shoh punët e drejtorit por jo edhe te subjektit e di qysh janë projektet..

z.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Po sqaroj sa i përket shpenzimeve deri 31.10.2022. Ne po flasim për zotimet e jo për shpenzimet e jo për shpenzimin qe mundë ta bëjmë deri në fund të vitit ju ftoj që ta votoni se ka me qenë një vite i mirë fiskal.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Të gjitha projektet janë të zotuara të gjithë e dimë se kemi pasur pa vështirësi. Operatorët i kanë kontratat p.sh. 140 mijë euro në një farë forme me i shpenzuar ato. Ju e dini se si ka shkuar puna atje ne do të jemi azhur. Gjithë e dimë çfarë kontrate të mirëmbajtjes e kemi pas, për dy muaj i keni shpenzuar gjitha mjetet është kosit bari në varreza të veteranëve 20 mijë euro.

z.Rexhep Gashi; Faleminderit për raportin por ne nuk jemi të kënaqur me 30% ku dihet që në këtë muaj përfundon cikli për zotimet 30 % për 9 muaj është shpenzuar, ndërsa 70 % për dy muaj, qysh mundet me u shpenzuar. Lëvdatat që po i marrin drejtorët nuk është mirë me i bë vetit por te epen nga dikush tjetër. Është mirë të merren shembull komuna ku i kanë shpenzuar më mirë buxhetet e jo Komuna ku janë të vogla shpenzimet në krahasim me buxhetin. Pse po merrni shembuj që e kanë shfrytëzua buxhetin me 9% pse s'po merrni shembull Komuna që e kanë shfrytëzuar buxhetin me 70 %. Lëvdata merrni në punë, populli do tu japë lëvdatat.

z.Hamëz Tërshani; Përsëndetje, u fol shumë për shpenzimet e mangëta apo të ulëta të buxhetit, flasim shumë për kontratën e mirëmbajtjes duke e pas parasysh që ekzekutivi ka obligim me bë zgjidhje. Unë e kam një pyetje për DPUGJK-në, nesër përfundon kontrata me kompaninë "Pastërtia", a është bërë përgatitja për renovimin e kontratë së re.

znj.Adelina Beqaj; Faleminderit për raportin ZKF-së, sa i përket shpenzimeve jemi dëshmitar të asaj se ky ekzekutiv nuk ka bërë shpenzimet e duhura, dhe nuk ka arrit ti qëndroj fjalës së tyre se këtë e kanë vullnet për punë momentin që vinë në pushtet. Kjo nënkupton se këta për 9 muaj kanë arrit me i shpenzuar vetëm 30 % të buxhetit të tyre. Dua me u lidh me asamblistët e VV-së është mirë mi rishikuar fjalimet para se dikush me ja u shkruan fjalimet, sepse tani po mbesin shumë keq, të hyrat vetanake normale që ka pasur rritje sepse kemi pasur një rritje të çmimeve të produkteve esenciale. Kështu që unë me këtë raport mbetem e zhgënjyer duke pasur parasysh me atë që keni folë e premtuar nuk qëndron, dhe dua me përmbyll me një thënie të famshme të ekzekutivit të Komunës së Shtimes, qytetarët e Shtimes nuk kanë me ja u falur kurrë këtë fillim të mbrapsht.

z.Rexhep Gashi; Faleminderit meqenëse jomë edhe subjekt politik, paraprakisht në qeverisjen e kaluar na edhe VV-ja, këputur jemi tu than Kompania “Ardhmëria” gjigante shumë punë po merr, tash e pash që shumë punë ka marr dikund 12 projekte, na duhet tani mi kërkuar publikisht falje operatorit sepse paske qen shumë i mirë, i kërkoj falje shumë, ishalla punon mirë e jo qysh ka punuar më herët, sepse ju ka ndalë shumë herë puna.

z.Përparim Ramusa; Në emër të PDK-së po e përmbylli. Qemajl Aliu është Kryetar i Komunës, nuk ka ndodh asnjëherë te asnjë Krytar as z.Fehmi Mujota e deri te ky që është për 9 mujorin e vitit me u shpenzuar 30% e buxheti të planifikuar, kjo është hera e parë që po ju ndodh qytetarëve të Komunës së Shtimes. Drejtorët dhe asamblistët e VV-së të njëjtin ngushëllim për mos punë e kanë te Komunitat tjera. Nuk na kanë votuar more qytetarët neve për Komunitat tjera, çka i intereson qytetarit të Komunës së Shtimes çka bahet në Vushtri ose dikund tjetër, ata na kanë votuar neve mi realizuar premtimet që janë. Si përfundim rritje e buxhetit është meritë e qytetarëve sepse ata i kanë paguar taksat po ekzekutivi nuk ka dit mi shpenzuar, nuk kanë dit me punuar. Kështu që për rritje të buxhetit unë publikisht i falënderoj qytetarët. Mendoj si subjekt politik që ky raport nuk ka arsyeje me u votuar.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë mendoj që kemi lidhje me gjitha Komunitat, është mirë me marr modele të mira por edhe të këqijat me i shikuar, faleminderit pasi nuk kemi të paraqitur unë dua me përmbyll. Mua më preku rasti kur tha z.Ramusa për renovimin dy shkollave, kisha pas qejf me dit cilat shkolla janë me emër.

z.Përparim Ramusa; Po Kryesues gjimnazi “Naim Frashëri” dhe shkolla fillore “Emin Duraku” tek Qendra Rinore që është.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Faleminderit, edhe te drutë a bung a qarr, aty duheni me dit që specifikacioni kur bëhet në kontratë nuk ceket se a duhet me kanë bung a qarr, është mirë me kanë por s’është specifikacioni. Tjetra drejtori Grejtalbi e tha që investimi për 2022 janë 1.9 milion, nuk është 2.3 milion. Kisha pas qejf me shkuar shifra ne 70-80%. Te votimi raportit nuk ndryshon gjë a e votojmë, dhe ky raport më nuk do të vije këtu. Në vitin 2023 Investimet do të shkojnë mbi 10 milion që kanë me u bërë në Shtime. E kam parë në gjitha Komunitat, Komuna e Shtimes është ndër 3 Komunitat liderë. Për shkak të inflacionit kemi pas probleme për ofertat e operatorëve. Te rritja e buxhetit është ne pyetje edhe rritja e besimit në qeverisje. Krahasimin e projekteve nuk duhet me bërë vetëm me shifra por edhe në teren. U fol për disa kompani, njëra prej tyre ka falimentuar. U thirren ne pandemi, por kompanit e ndërtimit kanë pas drejt me punuar. Te kompania “Pastërtia” është duke u shqyrtuar, sot kjo Kompani i ka 3 kamion më shumë e që më herët e kishin vetëm 1 kamion. A ka vend për më mirë ka vend për më mirë, a duhet të punojmë për më mirë po duhet. Ky është një raport që edhe nëse se votojmë nuk prish punë, por duhet me votuar se ky i jep statistikave e sakta. Po i drejtohem opozitës ka arritur një raport në janar dhe ne e kemi votuar, ka qenë i ish qeverisjes, se po e votove po se votove ai nuk ndryshon, tash ju nëse doni me votuar votoni kundër por s’do me than që ky kthehet prapë e shkon n shqyrtim po ky kryhet kjo punë.

z.Përparim Ramusa; Krahasimin që po e bënë nuk qëndron se atë raport e ka votuar Kryetari juaj raportin e vitit 2021 e keni votuar ju. Këtë raport nuk e votojmë ne sepse nuk jemi të kënaqur me punën e ekzekutivit.

z.Reshat Mujota; Faleminderit për lutjen që po e bënë, por kjo nuk shkon me lutje, ne nuk e votojmë për shkak të mos punës së juaj.

z.Rexhep Gashi; Kush na garanton neve që nuk i hupim mjetet e garantëve deri në funde të vitit. Nëse na garanton Kryetari unë jam në gjendje me votuar. Mendojë se ka përgjegjësi ligjore për humbjen e mjeteve.

z.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Zotni Gashi, ky është një raport që është bërë deri me 30 Shtator. Siç e dini e kemi edhe periudhën tjetër për të cilën do të raportojmë në funde të vitit. Zotimet nuk janë shpenzim.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Të gjitha zotimet janë të përfunduara përveç njëres në DKRS në shumën prej 10 mijë euro.

*** Kuvendi i Komunës, me 8 vota “Për” 10 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” nuk e miratoi Raportin Nëntëmuajor Buxhetor të Komunës së Shtimes Janar-Shtator 2022.**

Pika 4

Propozim-Vendim për caktimin e normave tatimore për vitin 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të ja jap fjalën z.Bujar Feratit për prezantimin e kësaj pike, lexoi rekomandimin e KPF-së.

z.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Sipas ligjit ne e kemi për obligim për me i prezantua në Kuvend normat tatimore për miratim. Norma më e ulët tatimore është 0.15%, ku edhe ne i kemi prezantuar të gjitha normat tatimore në këtë vlerë. Kjo nënkupton që Kuvendi e ka mundësinë vetëm që ta rritë ndonjëherë nga normat e propozuara, sepse më ulët nuk ka se si të shkon. Në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e kemi një propozim për ngritjen e normës tatimore nga 0.15% në 0.18% te objektet komerciale. Norma tatimore mundë të rritet më së shumti deri në 0.50%. Ju ftoj që ti votoni këto norma tatimore, dhe nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem.

z.Reshat Mujota; Faleminderit për prezantimin, sa e kuptova unë vetëm te objektet komerciale e kemi një ngritje prej 0.18% ndërsa te rubrikat tjera mbeten me 15%. Unë pajtohem me këtë propozim.

z.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Po është e vërtetë se e kemi një propozim për rritje të normës tatimore te objektet komerciale me 18%.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kuorumin prej 19 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimitisht miratoi, Normat Tatimore për vitin 2023 në Komunën e Shtimes.**

Pika 5

Draft-Rregullore për organizimin, funksionimin, dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime, dhe lagje urbane, në komunën e Shtimes

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të hap diskutimin e lexoi rekomandimin e Komisionit për hartimin e Rregullores së re të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve.

z.Reshat Mujota; Para se të fillojmë me këtë pikë unë propozojë 10 minuta pauzë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Mendojë se më mirë është që të vazhdojmë sepse kjo rregullore ka me shku në diskutim publik dhe nuk na merr shumë kohë.

z.Adem Ramadani; E përgëzoj Komisioni për draftin, mirëpo i kam disa vërejtje. Te pika 10 mandati është paraparë që të jetë 4 vjeçar, unë mendojë se aty duhet të ceket, se a kanë mundësi për me u rizgjedhë. Te neni 10.3.1 po shkruan që në votim duhet të përfshihen 51% unë mendojë se aty duhet të saktësohet se votimi duhet të jetë me 51 % të anëtarëve që janë prezent në mbledhje që votojnë nëse bëhet fjalë për shkarkimin e një kryesie. Neni 13 e keni harruar krejt mendojë se duhet të bëhet renditja e neneve në rregull. Pastaj edhe një propozim tjetër ku duhet të ceket se a ka të drejtë Kryetari me shkarku një anëtarë të Kryesisë. Te neni 12.8 unë mendojë se këtu nuk nevojitet pëlqimi i Kryetarit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kuorumin prej 19 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

*** Kuvendi Komunës, unanimitisht aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft-Rregulloren për organizimin, funksionimin, dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime, dhe lagje urbane, në Komunën e Shtimes, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Komisionit për ndryshimin e rregullores komunale për**

bashkëpunimin e Komunës me fshatrat dhe lagjet urbane Npi-01/89 në bashkëpunim me Zyrën për Informim.

Pika 6

Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm ngastrën kadastrale Nr.752-0, Z.K – Carralevë

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të hapi diskutimin lexoi rekomandimin e KPF-së, në vazhdim fjalën ja dha z.Grejtalb Eminit.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Te ky propozim vendim që e kemi paraqitur në Kuvend po bëhet fjalë për lokacionin e hyrjes te shkolla fillore në fshatin Carralevë. Lokacioni ku gjendet hyrja e kësaj shkolle faktikisht është pronë e një pronari privat i cili ka bërë kërkesë zyrtare për shpronësimin e asaj pjese të pronës. Kuvendi duhet që sipërfaqen prej 180m² ta shpallë me interes të përgjithshëm sepse për shkollën kjo është jetike. Ju ftojë që ta votoni këtë vendim dhe nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem.

z.Muhamet Ademaj; Ne si AKR e përkrahim këtë propozim vendim sepse është e rëndësishme për shkollën në Carralevë.

z.Përparim Ramusa; Jemi për plotësimin e nevojave të shkollës, dhe jemi për shpronësimin e kësaj pjese të pronës kështu që ne do ta votojmë.

z.Rexhep Gashi; Nuk jam kundër por çështja se si e ka bërë kërkesën pronari është joserioze sepse është pak e megjulluar, sa po shohë unë këtu po na ndryshojnë numrat e ngastrave kadastrale. Unë po kërkojë nga drejtori që këto gjëra të na i sqaroj.

z.Asllan Beqaj; Përhëndetje, në emër të grupit të asamblastëve të Lëvizjes së Vetëvendosjes e përkrahim këtë propozim-vendim për sa i përket shkollës në Carralevë.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Kërkesa është për 1 ari e 80 metra, kjo sipërfaqe duhet të shpronësohet.

z.Reshat Mujota; Kërkojë që të definohet mirë në fletën poseduese mos me u votuar me kërkesë por me propozimin e drejtorisë.

***Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi, vendimin për shpallje me interes të përgjithshëm pjesën e Ngastrës Kadastrale, Nr.P-72809089-00752-0; Zona Kadastrale – Carralevë, te Vendi i quajtur “Beshenik”; Kualiteti i klasës së tokës – Kullosë e klasës së 5 (pestë), Evidentuar në emër - Bashkpronësi e Besnik (Vehbi) Çerkini dhe Nazmi (Xhafer) Fazliu, me sipërfaqe totale 11223 m², me arsyetimin, që të hapet rruga për qasje të papenguar të njerëzve dhe mallrave deri te objekti i shkollës SHFMU “Avdullah Shabani” në fshatin Carralevë. Shpronësimi duhet të bëhet edhe për arsye se deri tani nuk ka qenë e definuar me akte zyrtare kjo qështje, dhe tani bashkëpronarët e kësaj ngastrë kanë kërkuar që prona të na shpronësohet ose ne nuk do të lejojmë shfrytëzimin e hyrje-daljeve nëpër pronën tonë.**

Pika 7

Propozim – Vendim për formimin e Komisionit për Hartimin e Rregullores së re të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; E kemi propozuar një vendim për formimin e Komisionit për hartimin e rregullores së re të punës së Kuvendit dhe Komiteteve. Anëtarët të cilët do të zgjedhën në këtë Komision do të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Komisionit. Të bëhet një rregullore për Kuvend e jo për pozitë ose opozitë.

z.Përparim Ramusa; Unë propozojë Adelina Beqaj. Ne jemi për këtë propozim-vendim që të bëjmë një rregullore të re të punës së Kuvendit dhe Komiteteve.

z.Reshat Mujota; Pajtojë që ky Komision me qenë prej 5 anëtarëve ju lus që në Komision të shkojnë persona profesionist e jo ata që nuk njohuri për rregullore.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Kadri Emini mundë të jetë prej kandidatëve që do të japë kontributin e tij në këtë hartimin e kësaj rregullore.
znj.Shkurte Mustafa; Në emër të Lëvizjes Vetëvendosjes propozojë Asllan Beqaj.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi Vendimin për formimin e Komisionit për Hartimin e rregullore së re të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve në këtë përbërje:**

1. Valon Januzi – përfaqësues nga ekzekutivi,
2. Yllka Fejzullahu - përfaqësuese nga ekzekutivi,
3. Adelina Beqaj – përfaqësuese nga opozita,
4. Asllan Beqaj - përfaqësues nga pozita,
5. Zhaneta Demiri - përfaqësuese nga OJQ-të.

Pika 8

Draft-Strategjia për komunikim dhe marrëdhënie me publikun për periudhën 2023-2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha Anita Kurti.

znj.Anita Kurti, zyrtare për informim; Përshëndetje, strategjia e tanishme e Komunës së Shtimes është e skaduar dhe ne kemi dashtë ta hartojmë një strategji kemi formuar një Komision prej 7 anëtarëve të cilin e ka formuar Kryetari z.Qemajl Aliu , kjo strategji është edhe një kusht që kërkohet për agjendën evropiane ju ftojë që ta aprovoni.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Edhe kjo draft-strategji do të shkojë në diskutim publik.

z.Përparim Ramusa; Faleminderit Anita jemi që të shkojë në diskutim publik dhe do ta japim kontributin lidhur me këtë strategji.

*** Kuvendi Komunës, unanimisht aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft-Strategjin për komunikim dhe marrëdhënie me publikun për periudhën 2023-2025, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Zyra për Informim.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoj në ora 11:35h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

